REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 77/16
Datë/Datum. 06.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **77/16** e OE **"Geo&Land"** - Prishtinë.		
Datë:	06.04.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 16.03.2017 me Nr. **77/17** nga OE **"Geo&Land"** - Prishtinë, për shqyrtimin e lëndës **"Sistemi i menaxhimit të informacionit për nevojat e FSK-së" me numër të prokurimit 21700/16/072/115**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK).**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **GEO&LAND.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		27.03.2017		**27.03.2017**		**06.04.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 16.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 77/17 e parashtruar nga OE **"Geo&Land"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sistemi i menaxhimit të informacionit për nevojat e FSK-së" me numër të prokurimit 21700/16/072/115**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK).** Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK).**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "Geo&Land", me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **"Geo&Land"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 10 - Mjetet për promovimin e transparencës;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 62 – Përfundimi i aktivitetit te prokurimit;
Neni 65 – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve;
Neni 105 – Kompetencat e OSHP-së.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Procedura e ofertimit

Ne mendojme qe AK ka zbatuar ne mënyrë korrekte dhe shume te sakte aktivitetin fillestar për projektin e lartcekur. Vendosja e kritereve ka qene ne përputhje te plote me LPP. Ndërsa specifikimet teknike kane qene shume detale dhe ne nuk kemi hasur ne specifika me profesionale deri me tani. Gjithashtu gjate procesit para hapjes se ofertave ne si OE kemi marre sqarimet e kërkuara dhe nuk kemi ankesë në to. AK, ka shperndare dosjen dhe specifikat e projektit ne gjuhen shqipe, ndersa me kerkesen tone gojore na eshte ofru edhe specifika ne gjuhen angleze. Arsyen e kerkimit te specifikave ne gjuhen angleze e kemi bere ne menyre qe gjuha angleze ne shume raste eshte me e kuptueshme per ceshtje te IT. Ne kemi hasur ne nje perkthim shume te mire te specifikave sepse na eshte thene qe specifikat fillimisht jane realizu ne gjuhen angleze, gje qe eshte normale per fushen e TI. Ne, gjate pergatitjes se ofertes e kemi analizuar cdo detal ne gjuhen shqipe dhe angleze dhe nuk kemi lene pa perfshi asnje detal sipas kerkeses se AK.

2. Procedura e vleresimit

Me datën 06.12.2016 jemi njoftuar për anulimin e aktivitetit te prokurimit dhe me datën 07.12.2016 kemi bërë kërkesë për qasje në dokumentacion. Qasja na është ofruar me datën 08.12.2016 me këtë rast jemi informuar vetëm gojarisht dhe nuk na është lejuar të shikojmë dokumentacionin ofertues dhe raportin e vlerësimit Me këtë rast është shkelur LPP, neni 10, paragrafi 3, 4 dhe 5. Nga AK na është

konfirmuar që ne kemi ofruar çmimin më të ulët se të gjithë OE tjerë dhe që ofertat në aspektin teknik nuk janë hapur fare sepse komisioni i vlerësimit të ofertave ka vërejtur lëshime teknike. Në pyetjen tonë që të arsyetoni shkeljet eventuale me nen të caktuar të LPP, AK nuk na dëshmoi të njëjtën. Arsyetimi kryesor sipas tyre eshte mosofrimi i Certifikates se sigurise (Dokument i paqarte per ne). Ne ju sqaruam qe Certifikatat eventuale te sigurise nuk mund te jene kriter dhe pjese e dosjes pasi ato jane ne kundershtim me LPP dhe nuk ka vendim sipas ligjit per klasifikimin e informacionit. Ne besojme qe AK nuk ka mund ta parashohe kete dokument ne dosje, dhe se ky dokument eshte vetem pretekst per anulim pa mbulese ligjore. Zakonisht dhe sic parashihet me udhezimet nga LPP, specifikat teknike pergatiten nga profesionistet dhe se pas publikimit te pyetjeve/sqarimeve ne mes te OE dhe AK ky specifikacion konsiderohet i rregullt. Tendenca kryesore ne kete rast eshte qe komisioni vleresues, ne vend qe ti vleresoje ofertat ajo e ka vleresu specifikacionin teknik dhe e ka vu ne dyshim kompetencen profesionale te hartuesve te specifikacioneve teknike, gje qe eshte e pakuptimte. Pas takimit ne u bindem per mungese ligjore te anulimit te tenderit dhe me daten 08.12.2016 i jemi drejtuar KRPP per interpretim ligjor dhe mendim profesional. Se bashku me interpetimin nga KRPP (te dates 09/12/2016) ne i jemi drejtuar AK per rishqyrtim te procedurave me daten 09.12.2016. AK me daten 14.12.2016 nanjofton me refuzimin e rishqyrtimit te tenderit, por prape pa deshmuar ligjshmerine e refuzimit ashtu sic pretendojme ne dhe KRPP. Ne arsyetimin e AK per refuzim fare nuk permendet interpretimi i KRPP dhe me kete rast ne si OE erdhem ne perfundim qe AK nuk i perfill fare rekomandimet e KRPP dhe pretendimet tona te paraqitura ne ankesen per rishqyrtim.

3. Shkeljet ligjore nga AK

Duke marre parasysh natyrën e projektit me procedurë të kufizuar dhe negocim, ne pretendojmë shkelje ligjore mos vlerësimin e ofertave veç e veç nga ana AK, ashtu siç parashihet në LPP. Me këtë rast ne pretendojmë për diskriminim në momentin që është bërë verifikimi i çmimeve, ku ne si OE jemi më të favorshmit (Çmimi më i ulët) dhe te njejten kohe AK nuk ka proceduar me vleresim te ofertave.Anulimin i këtij aktivitetit të prokurimit në këtë mënyrë, pa i vlerësuar fare OE e konsiderojmë si diskriminues dhe jo transparent dhe ne kundershtime me nenet e lartecekura te LPP. Arsyeshmëria e anulimit nuk koincidon me asnjë nen të LPP dhe si rrjedhojë ky anulim nuk ka bazë ligjore por është vetëm vlerësim subjektiv i njëanshëm dhe duke mos marre parasysh interpretimin e KRPP-se. Ne pretendojme qe AK nuk ka justifikim ligjor per anulimin e tenderit, ata e marrin si pretekst leshimin teknik te cilin kinse e kane bere. Ne kemi dyshime te bazuar qe AK po e perdor kete "TRIK" vetem per te na diskriminuar ne si OE, ne momentin qe ata e kane verejtur qe ne jemi ofertuesit me te lire. Te njejtin "TRIK", AK e ka perdorur kunder nesh edhe gjate vitit 2016 ku ne nje projekt tjeter te FSK ne si OE ishim me te liret dhe ata prape e anuluan tenderin me pretekstin e njejte te mosperputhjes se termave te references. Ky veprim, përpos që është i dëmshëm për ne si OE, meqë ne gjatë përgatitjes së ofertës kemi shpenzuar shumë investim e sidomos në konsultim me të gjithë akterët dhe standardet relevante për të përgatitur një ofertë e cila jo vetëm që i përmbush kërkesat e AK, por i kalon ato në vlerën rreth 35%. Andaj do të ishte një dëm i madh për AK të mos e vlerësoje një ofertë të tillë. Po të vlerësonte AK ofertat secilën veç e veç pa paragjykuar rezultatin perfundimtar, ne do te bindeshim per korrektesi por ky veprim I AK per ne eshte shum diskriminues. Thirrja e AK në nenin 62 te LPP në këtë rast nuk është dëshmuar, dhe me interpretimin nga KRPP ky konstatim i yni ligjerisht eshte forcuar. Ne shpresojme qe OSHP te merre ne konsiderate keto fakte per shkelje ligjore nga ana e AK dhe te rikthej ne vlersim tek AK, vlerësimin e ofertave veç e veç, ashtu siç e

parashikon ligji. Fakt tjeter i pamohueshem eshte qe AK ne dosjen e tenderit (Procedure e negocuar) parasheh negocimin teknik te ofertes dhe se cdo leshimi mundshem sic pretendon AK mund te rregullohet gjate procedures se negocimit. Ne jemi te bindur qe AK nuk ka shpreh interesim per te rregulluar leshimet eventuale, por ka qene e interesuar ta anuloje tenderin pasi qe ne jemi OE me ilire. Pra, ne mendojme qe ketu nuk behet fjale per leshime teknike dhe se ato jane vetem supozime per qellim te diskriminimit te nje OE.

Arsyet e paraqitura ne njoftimin e anulimit nga ana e AK nuk koincidojnë me asnjë nen të LPP, pra janë plotësisht te paqëndrueshme dhe të bazuara ne vlerësim subjektiv e te njëanshëm. Bazuar ne LPP shume qarte është e definuar se te gjitha kërkesat ne lidhje me shërbimin apo produktin qe kërkohen paraqiten ne kuadër te specifikimeve teknike, ku me këtë rast AK ka paraqitur këto në mënyrë shumë profesionale. Ndërsa të gjitha kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale paraqiten në kuadër të Seksionin II te dosjes se tenderit, FDT neni 9.1 dhe 9.2, te cilat po ashtu janë paraqitur ne dosjen e tenderit. Si rrjedhojë, në dokumentacionin e këtij AP nuk ka asnjë mospërputhje të kërkesave ashtu siç është paraqitur si arsyetim në vendimin e anulimit. Edhe sikur te kishte, ne Seksionin II te dosjes se tenderit thuhet se: "Kurdo qe paraqitet ndonjë mospërputhje, këto dispozita do të mbizotërojnë mbi ato ne Informata për Tenderuesit".

Ne kemi kërkuar interpretim ligjor nga KRPP për këtë çështje dhe ata si autoriteti më i lartë për interpretim të ligjërisë e konfirmojnë pretendimin tonë. Përgjigja nga KRPP është e bashkëngjitur me këtë ankesë.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit të KRPP për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë: 28.09.2016

Lloji i procedurës së aplikuar:..... *negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë*

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....vlerë e madhe

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 21.11.2016

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Lloji i kontratës:.....*Kontratë 24 muaj*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Binak Zeka - Kryetar i komisionit
- Hafize Bajrami - Anëtar i komisionit
- Gyner Murati - Anëtar i komisionit
- Bob Powers – Vëzhgues
- Radovan Srsa – Vëzhgues.

Data e mbarimit të vlerësimit: 28.02.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....01.03.2017

Data e njoftimit për anulim te aktivitetit të prokurimit:.....01.03.2017

Raporti i komisionit vlerësues:
Komisioni gjate pergaditjes se dokumentacionit per fillimin e procesit te vlerësimit. Ekzaminimit dhe krahasimit te tendereve ka ardhur t te dhenat qe e pamundesojn punene e mëtutjeshme dhe bazuar ne to konstaton si me posht:

1. Ekziston mospërputhje e projektit ndermjet versionit ne gjuhen shqipe dhe gjuhen angleze si pasoj e kësaj jan [paraqitur dy pale kritere te vlerësimit te cilat e bejne te pamundur vazhdimin e procedurave te vlerësimit te tendereve.
2. Ekziston nje mospërputhje ndermjet kërkesave te përcaktuara ne FDT dhe projektit (pika 7..2.1), kërkesat per kontraktonin dhe produktet qe ofron, ne lidhje me kërkesat te cilat duhet ti plotësoj OE ofertues.

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik në lidhje me arsyet e anulimit te aktivitet te prokurimit.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, ja refuzon ankesën si të pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, pas vendimit me nr. 465/16, te datës: 09.02.2017, ka formuar komisionin e Ri-vlerësimit, dhe i njëjti ka konstatuar si ne vijim:

Komisioni për Ri-vlerësim, ekzaminim, krahasimin e tenderëve dhe negocimin e ofertave, duke u bazuar ne te gjeturat e komisionit paraprak dhe te konfirmuara edhe nga ky komision i ri-vlerësimit, si dhe informacioneve te tjera plotësuese te ofruara nga njësia kërkuese ne lidhje me projektin e pamundësojnë punën e mëtutjeshme te këtij komisioni Ri-vlerësuespër te filluar vlerësimin e ofertave për shkak te zbatimitte kritereve te përzgjedhjes te kërkuara ne DT si dhemangësive nespecifikacionet teknike dhe te përformancës (projektit)e qendikojnë drejtpërsëdrejti ne realizimin e qëllimit te kontratës ne fjale, andaj ky komision Ri-vlerësues fare nuk ka bere vlerësimin e ofertave për arsyesi me poshtë:

1. Ekziston një mospërputhje ndërmjeti kërkesave të përcaktuara ne Fletën e Dosjen e Tenderit(FTD) dhe Projektit(pika 7.2.1 Kërkesat për Kontraktorin-OE dhe produktet qe ofron, në lidhje me kërkesat të cilat duhet ti plotësoj Operatore Ekonomik ofertues.

2. Projekti i SMI-së duhet të jetë dokument i klasifikuar, ngase ne fazën e implementimit dhe integrimit të të dhënëve behet i ndjeshëm bazuar në ligjin për klasifikimin e dokumentacionit në RKS neni 4 pika 1.3.2. mbrojtje, plane ushtarake, sisteme armësh, apo operacione dhe pika 1.3.5. sisteme, instalime, infrastruktura, projekte, plane apo shërbime të mbrojtjes që lidhen me interesat e sigurisë të Republikës së Kosovës;

3. Kompania përzgjedhëse e projektit SMI duhet të jete e verifikuar dhe e pajisur me certifikatë të sigurisë bazuar në nenin 45 dhe 46 të po të njëjtit Ligj. (pika 1 dhe 2) Pronarët, menaxhuesit dhe punonjësit e shoqërive tregtare dhe nën-kontraktuesit e tyre, të cilët janë të ftuar për të bërë ofertë, për të negociuar apo përmbushur një kontratë të klasifikuar apo që në një formë tjetër mund të ju jepet qasje në informacione të klasifikuara, kanë qasje në informacione të tilla të klasifikuara me kusht që të kenë leje të vlefshme të sigurisë të lëshuar nga Autoriteti Verifikues dhe që të kenë nevojë që të jenë në dijeni për këto informacione. Informacioni i klasifikuar i jepet një shoqërie tregtare vetëm me pëlqimin e institucionit publik nga i cili e ka origjinën ky informacion.

4. Neni 46 i po të njëjtit Ligj (Pika 1 dhe 2). Shoqëritë tregtare dhe nën-kontraktuesit e tyre, pronarëve, menaxhuesve apo punonjësve të të cilëve u është dhënë në mënyrë të ligjshme qasje në informacione të klasifikuara garantojnë që objektet e tyre afariste, ku përdoren informacionet e tilla, i përmbushin standardet e sigurisë siç është përcaktuar me këtë ligj dhe me aktet nënligjore. Autoriteti Verifikues i inspekton objektet e tilla dhe e ndalon qasjen në informacione të klasifikuara nëse objektet afariste nuk i përmbushin standardet e sigurisë të përcaktuara në këtë ligj dhe me aktet nënligjore përkatëse. Autoriteti Verifikues, kohë pas kohe dhe pa njoftim paraprak inspekton objektet e shoqërive tregtare të cilat kanë qasje në informacione të klasifikuara.

5. Projekti i SMI-së duhet të rishikohet në tërësi ngase finalizimi i tij ka ndodhur para se të finalizohet Plani Afatgjatë Zhvillimor, Strategjia për Mbrojtje Kibernetike dhe Plani i Transformimit të MFSK-së dhe FSK-së. Në këtë drejtim:

   - Numri i shfrytëzuesve i kërkuar me projekt dhe specifikacione teknike është shumë i vogël dhe nuk është në harmoni me strukturën e re.
   - Kërkesat e organizatës për menaxhimin e pajisjeve dhe armatimit nuk është në harmoni me sistemin e FOCIS (Sistemi Informatik i Forcës i orientuar në Kosto) dhe me TOE (tabelën organizative të pajisjeve)
   - Sistemi nuk përkrah strukturën sipas rekomandimeve të RSSS-së
   - Projekti i SMI-së duhet të rishikohet ngase ekziston një dis-harmoni ne mes të versionit shqip dhe versionit anglisht, në versionin shqip shpesh eshtër përdoruar një terminologji teknologjike e pakuptueshme.

REKOMANDIM:

1. Bazuar ne këto konstatime, Rekomandohet të anulohet procedurat e prokurimit bazuar ne nenin 62, pika 1.1, te ligjit nr. 05/I-092 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/I-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/I- 237 dhe me ligjin nr. 05/I-068, ku thotë " **një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit".**
2. Rekomandojmë qe kërkesa për prokurim për projektin "Sistemi i menaxhimit të Informacionit për nevojat e FSK-së"(projekt dy vjeçare), numri i prokurimit: 21700/16/072/115,, tëkthehet për ri-plotësimsipas rekomandimeve të me poshtme:

- Të harmonizohen versionet në të dy gjuhet dhe njehërit të ceket se cili version i projektit duhet të mbizotëroj në raste të ndonjë mosmarrëveshje
- Te harmonizohen te gjitha kërkesatteknike/ose profesionale dhe të sigurisëndërmjet kërkesës për prokurim, projektit dhe dokumenteve standardet te prokurimit ne mënyrë qe te kemi një pale kritere te përzgjedhjes dhe jo kritere te dyfishta.
- Te involovohen te gjithë palët te cilat mund te japin kontribut profesional për këtë aktivitet te prokurimit duke dhënë mendim profesional, për shkak te ndjeshmërisë së projektit dhe te vendoset, se kur dhe në cilën fazë do të kërkohet certifikata e sigurisë qe lëshohet nga institucione relevante në përputhje me legjislacionin ne fuqi duke ju referuar pikave te lartshënuara 2 ; 3 dhe 4.

3. Rekomandojmë njësisë kërkuese qe ne bashkëpunim me departamentet të tjera, të shqyrtoj pikë për pike kërkesat te cilat duhet ti plotësojnë Operatorët Ekonomik dhe te njëjtat. te paraqiten ne dokument te veçantë (kërkesë për prokurim) tek autoriteti i prokurimit.

Rekomandojmë njësisë kërkuese të bëjë plotësimin e projektit me te gjitha te dhënat e lartshënuara me qellim te zbatimit sa me profesional te qëllimit te kontratës duke zbatuar parimet themelore te LPP-se.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne konstatimin e komisionit Ri-vlerësues sqaron se arsyet e anulimit te këtij aktiviteti te prokurimit janë te njëjta me ato te herës se pare, pra kryesisht rreth anulimit te aktiviteti te prokurimit komisioni Ri-vlerësues është bazuar ne mospërputhjen e versioneve te dosjes se tenderit sipas dispozitave te nenit 13 te Ligjit për Prokurim Publik, pretendime te cilat janë shqyrtuar edhe ne ekspertizën e pare. Prandaj, konform rregullores se punës se OSHP-se, përkatësisht nenit 18.2, eksperti shqyrtues e njofton panelin shqyrtues, si rast te gjykuar me pare - te njëjtë, andaj ankesa e OE ankues duhet te refuzohet si e pa bazuar dhe njëherit i propozon panelit shqyrtues qe ta aprovoj vendimin e AK-se si te bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimin e cekur në ekspertizë mendon që vendimi për anulim i Autoritetit Kontraktues – **Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK)**, për aktivitetin e prokurimit **"Sistemi i menaxhimit të informacionit për nevojat e FSK-së" me numër të prokurimit 21700/16/072/115,** te aprovohet si i bazuar, ndërsa ankesa e OE ankues te refuzohet si e pabazuar.